



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**  
**SEKTORI I KURRIKULËS, VLERËSIMIT INSTITUCIONAL DHE ALUMNI**

Nr. 123 prot.

Korçë, më 28.01.2022

**RELACION**  
**LIDHUR ME RAPORTET E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PËR SECILIN**  
**FAKULTET**  
*(përfundime, problematika, rekomandime)*

Raportet e vlerësimit të brendshëm për secilin fakultet prezantojnë rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve profesionale, referuar Nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikime, programeve të ciklit të parë të studimit "Bachelor" dhe programeve të ciklit të dytë "Master" në Universitetin "Fan S. Noli" në Korçë, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm.

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim korrekt, të bazuar në tregues realë dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë përsa i përket misionit të Universitetit, programeve të studimit, mësimdhënies, sigurimit të cilësisë, stafit dhe studentëve.

Për vitin akademik **2020-2021**, bazuar ne RVB-të e katër fakulteteve, kemi rezultatet e permbledhura si me poshtë:

**TË DHËNA PËRSHKIMORE-VITI AKADEMIK 2020-2021**

***-Misioni***

Universiteti "Fan S. Noli" (UNIKO) me 4 fakultete ka si mision të vetin zhvillimin e një procesi mësimor e kërkimor sfidues, me infrastrukturë moderne, e cila përfshin bibliotekën (me fonde librash që shtohen herë pas here), laboratorë të ndryshëm (në përputhje me kërkesat e programeve të studimit) si dhe teknologji bashkëkohore. Misioni i tij është të sigurojë një arsimim cilësor për studentët dhe të ofrojë përgatitje profesionale në edukim, por njëkohësisht të arrihen standardet e kërkuara në tregun e punës duke ofruar programe studimit që formojnë specialistë dhe mësimdhënës në drejtime të ndryshme (në varësi të programeve të studimit).

Studentët përgatiten dhe diplomohen për një spektër të gjerë njohurish, e cila i ndihmon në zhvillimin e karrierës së ardhme dhe mbi të gjitha përgatiten si individë ndikues dhe kontribues në shoqëri përmes dijeve dhe shërbimit.

Universiteti ka një strategji zhvillimi afatgjatë për përmbushjen e synimeve dhe qëllimeve të mishëruara në vizionin dhe misionin e tij.

Objektivat kryesor të të gjitha programeve të studimit që ofron Universiteti ynë synojnë që t'u japin studentëve njohuritë e nevojshme dhe bazë për formimin e tyre si

specialistë të aftë në fushat: ekonomi, bujqësi, shkenca edukimi, shkenca natyrore dhe humane.

Megjithë punën e mirë që është bërë deri tani për realizimin e objektivave kryesore, ka ende shumë punë për të bërë kryesisht në rritjen sasiore të numrit të studentëve por edhe rritjen cilësore të tyre si edhe të mësimdhënies dhe të të nxënit.



### ***-Programet***

Programet e UNIKO janë hartuar në përputhje me objektivat dhe misionin e tij, tashmë të përshkruara qartë në Statutin e tij dhe në Planin Strategjik të Zhvillimit.

Programet e studimit synojnë formimin e shprehive të veçanta në një shumëllojshmëri profesioneve e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit. Nëpërmjet, kurrikulës koherente me nevojat e tregut të punës, studentët fitojnë kompetenca profesionale, të cilat gjenerojnë rezultate të pritshme.

Programet e studimit që ofrohen nga UNIKO plotësojnë kërkesat e maturantëve. Kurrikula aktuale e programeve të studimit është vazhdimisht e ristrukturuar me qëllim rritjen e vlerës së diplomës së dhënë në tregun e punës. Janë parashikuar programe të reja për t'u hapur me qëllim furnizimin e tregut me kualifikime praktike profesionale.

### ***-Sigurimi i cilësisë***

Për çdo vit akademik Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni harton kalendarin e veprimtarisë së sektorit të kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë i cili ndiqet nga NJSBC së fakultetit.

NJSBC kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me pyetësorë me të gjithë studentët, për lëndët dhe pedagogët. Rezultatet përpunohen në raporte periodike.

Kurrikulat e Programeve të studimit janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe të përafruara me programe homologe jashtë vendit. Programet e studimit ruajnë një ekuilibër mjaft të mirë ndërmjet moduleve të vlerësuara me kredite sipas tipologjive të lëndëve: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, integruese dhe plotësuese. Modulet karakterizuese dhe integruese formojnë shprehi të përshtatshme praktike për arritjen e standardeve në ofrimin e shërbimeve profesionale, sigurimin e një konteksti akademik për diskutimin e çështjeve që lidhen me fushën e ngushtë të natyrës së programit, për t'u përgatitur sa më mirë për integrimin në tregun e punës, me synim zhvillimin e perspektivës teorike të studentëve dhe e kompetencave analitike.

### ***-Stafi***

Departamentet e secilit fakultet zhvillojnë periodikisht vlerësime të stafit akademik dhe mbajnë një bazë të dhënash për raportet e rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë etj.

Angazhimi në veprimtaritë kërkimore-shkencore dhe kualifikimi i vazhdueshëm janë pjesë e rëndësishme e punës së pedagogut. Rritja e cilësisë së mësimdhënies ka për bazë edhe arritjet në punët kërkimore-shkencore.

UNIKO ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekrutimit të burimeve njerëzore. Procedurat e përzgjedhjes janë të hapura, me konkurs dhe me objektiv përzgjedhjen e personave të kualifikuar që zotërojnë grada e tituj shkencorë. Institucioni ka një Udhëzim të posaçëm rekrutimi. Kjo procedurë administrohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit. Për rekrutimin e personelit është

ndjekur procedura e shpalljes publike të pozicionit të punës, dhe të kriterëve në Buletin e Njoftimeve Publike si dhe në website-in e Universitetit.



### ***-Studentët***

Infrastruktura në dispozicion të mësimi është ndërtuar posaçërisht në funksion të mësimdhënies dhe mjediset kanë kapacitet të plotë dhe hapësira komode të akomodimit të studentëve.

Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimeve; vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit.

Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës, informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit, informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtaritë akademike, kulturore, njoftime etj., nëpërmjet “Katalogut të Studimeve”. Po ashtu informohen për rezultatet e analizave të ndryshme apo politika të ndërmarra nga Rektorati, Bordi i Administrimit, Senati Akademik etj.

Përsa i përket të diplomuarve, rrjeti ALUMNI i universitetit përditëson të dhënat nëpërmjet gjurmimit të tyre me telefon, email, ose formularë të shpërndarë në terren, me qëllim jo vetëm sigurimin e informacionit por edhe për të shkëmbyer përvojat më të mira në fushën e arsimimit dhe punësimit.

### ***-Biblioteka dhe shërbime***

Fondi i librave dhe revistave është i klasifikuar sipas natyrës së departamenteve dhe fushave përkatëse të studimit. Librat që ofron kjo bibliotekë janë të ndryshëm në përputhje me kërkesat. Tematika e tyre është e gjerë, kryesisht janë libra shkencorë tema disertacioni, revista, buletine etj. Biblioteka, e cila shërben njëkohësisht si sallë studimi me fonde të hapura, është e pajisur me kompjutera, internet si dhe me sistem ngrohje që u vjen shumë në ndihmë studentëve për lexim, studim e fotokopje të materialeve të ndryshme bibliotekare.

## **TË DHËNA SASIORE-VITI AKADEMIK 2020-2021**

### ***-UNIKO garanton marrëdhënie bashkëpunimi, të brendshme dhe të jashtme***

Në tabela më poshtë jepet numri i marrëveshjeve aktive dhe të nënshkuara gjatë vitit akademik 2020-2021 sipas ndarjeve: marrëveshje ndërkombëtare, kombëtare dhe në katër fakultetet.

	<b>Ndërkombëtare</b>	<b>Kombëtare</b>	<b>FB</b>	<b>FE</b>	<b>FEF</b>	<b>FSHNSHH</b>
<b>Marrëveshjet aktive në total</b>	37	45	16	22	10	21
<b>Marrëveshjet për vitin akademik 2020-2021</b>	12	21	16	8	9	16

### ***-Kualifikimi i stafit***

<b>Stafi</b>	<b>Numri</b>
Rektor	1
Zëvendësrektor	2
Dekan	4
Zëvendësdekan	4
Përgjegjës Departamenti	15
<b>Stafi me kohë të plotë</b>	
Profesor	5
Profesor i asociuar	28
Lektor-PhD.	5
Lektor-Dr.	73
Lektor-Doc.	4
Asistent Lektor-Msc.	38
<b>Stafi me kohë të pjesshme</b>	
Profesor	20
Profesor i asociuar	3
Lektor-Dr.	15
Asistent Lektor-Msc.	88



*-Numri i studentëve të regjistruar dhe të diplomuar*

	<b>FB</b>	<b>FE</b>	<b>FEF</b>
<b>Studentë të regjistruar</b>	369	645	599
<b>Studentë të diplomuar</b>	95	267	269
<b>Përqindja e studentëve të diplomuar</b>	26%	41%	45%

*-Kërkimi shkencor*

	<b>Emërtimi</b>	<b>FB</b>	<b>FE</b>	<b>FEF</b>
1.	<b>Projekte (pjesëmarrje)</b>	5		
2.	<b>Konferenca Ndërkombëtare</b>	3		43
3.	<b>Konferenca kombëtare</b>	1		7
4.	<b>Simpozium</b>			16
5.	<b>Seminar</b>	3		9
6.	<b>Lektorium</b>			
7.	<b>Workshop</b>	6		6
8.	<b>Tekste</b>		1	4
9.	<b>Monografi</b>	1		4
10.	<b>Dispensa</b>	6		4
11.	<b>Artikuj shkencorë</b>	12	10	32
12.	<b>Trajnime/Webinars</b>	2		9
13.	<b>Projekte</b>	8		5



## ANALIZA SWOT

### **a. Pika të forta:**

- UNIKO mbështetet në një vizion të mirë përcaktuar, mision dhe plan të zhvillimit strategjik të qartë, të plotë, bashkëkohor. Dokumenti i Planit Strategjik të Zhvillimit të institucionit është një dokument që orienton drejt dhe me realizëm zhvillimin në kontekstin e institucionit, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.
- Programet janë ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin e institucionit, nevojat e tregut.
- Programe akademike bashkëkohore. Kurrikula të veçanta në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit.
- Shkalla e lartë e kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik të brendshëm të fakultetit dhe atij mbështetës.
- Respektimi i standardeve akademike. Programet e studimit respektojnë standardet akademike. Plani mësimor, syllabuset metodat e mësimdhënies e mësimnxënies janë sipas kërkesave të standardeve akademike.
- Përdorimi me efektivitet i pajisjeve audiovizive për zhvillimin e mësimin dhe të veprimtarive të tjera, si dhe internet 24 orë.
- Ambjente dhe laboratorë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e orëve të mësimin.
- Zhvillimi i programeve të nivelit të dytë Master Profesional dhe Shkencor.
- Pjesëmarrja e stafit në konferenca kombëtare e ndërkombëtare si edhe bashkëpunime në botime artikujsh shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
- Marrëdhënie të mira me studentët.
- Infrastrukturë funksionale që përpiqet drejt trendeve bashkëkohore.
- Bashkëpunim i institucionalizuar me institucione homologe dhe institucione të tjera bashkëpunuese për të realizuar objektivat për kërkimin, shkëmbimin e eksperiencave dhe punësimin e të diplomuarve.

### **b. Pika të dobëta:**

- Numri i studentëve jo në nivelet e planifikuara.
- Cilësia relativisht e dobët e studentëve në hyrje për disa programe studimi.
- Përdorimi i joeficient i burimeve të bibliotekës.
- Mungesa e mundësive për të krijuar lidhje të mira të teorisë me praktikën për pajisur studentët me aftësi praktike.
- Pjesëmarrje e ulët në projekte.

### **c. Mundësitë**

- Eksperienca dhe kualifikimet e stafit akademik rrit mundësinë për të aplikuar dhe bërë pjesë e projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare prej të cilave mund të përfitojnë direkt dhe/ose indirekt studentët.
- Miratimi i programeve të nivelit të dytë.
- Shanse për rritjen e bashkëpunimeve.
- Pozita e favorshme gjeografike e rajonit për tërheqjen e studentëve edhe nga vendet kufitare për programe të ndryshme studimi.
- Mundësi punësimi si rezultat i rritjes të kërkesës të tregut për profesionet që lidhen me programet që UNIKO ofron.

#### **d. Pengesat**

- Hapja e programeve të reja në Universitetet e tjera.
- Faktorët demografikë të cilët projektojnë në të ardhmen një vijim të rënies së numrit të nxënësve të rregjistruar në arsimin parauniversitar.
- Vështirësi në rekrutimin e një stafi të kualifikuar.



#### **REKOMANDIME DHE STRATEGJI TË NXJERRA NGA NJSBC PËR PROBLEMATIKAT E HASURA:**

- Të rritet cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies, nëpërmjet përdorimit të teknikave të reja, përditësimit të materialeve dhe pasurimit me shembuj nga praktika, sidomos gjatë mësimdhënies online, për të shmangur vështirësitë në kuptimin e temave të mësimin dhe për të mbajtur studentët e interesuar dhe aktivë.
- Të nxiten studentët për të realizuar detyrat dhe projektet e përcaktuara në vlerësimin e vazhduar të çdo lënde, si edhe të përmirësohen mënyrat e vlerësimit të vazhduar duke u mbështetur në procesin e zhvillimit online të leksioneve, seminareve apo dorëzimit të detyrave të kursit.
- Të nxitet orientimi i procesit të mësimnxënies bazuar në kompetencat si edhe të rritet numri i konsultimeve në lëndët ku kalueshmëria është më e ulët;
- Të vazhdojë organizimi i veprimtarive të ndryshme shkencore, kulturore, sociale, me synim përfshirjen sa më të gjerë të studentëve në to, si edhe të rritet pjesëmarrja e studentëve në projekte, konferenca studentore, tryeza të rrumbullakëta, studime kërkimore etj., si mënyra motivuese për studentët;
- Të gjenden mënyra të reja për të tërhequr më shumë studentë dhe më cilësorë në të gjitha programet e studimit;
- Të hartohen strategji për promovimin e programeve të studimit dhe përthithjen e një numri sa më të madh studentësh;
- Të përditësohet baza e të dhënave për ruajtjen e lidhjeve me studentët e diplomuar;
- Të vendosen lidhje të qëndrueshme me bizneset dhe institucionet për të orientuar studentët e diplomuar drejt pozicioneve të kërkuara të punës;
- Të nxitet kualifikimi i mëtejshëm i stafit akademik, për përfundimin e studimeve doktoare, si dhe të lobohet maksimalisht, pranë instancave përkatëse, për shpejtimin e procedurave të marrjes së titujve shkencorë nga pedagogët;
- Të nxitet përfshirja e stafit akademik në projekte e trajnime, në funksion të kërkimit shkencor të avancuar si dhe të fushës së mësimdhënies;
- Të vazhdojë puna për përmirësimin e kurrikulave, duke i lidhur ato më tepër me kërkesat e tregut të punës dhe pajisjen e studentëve me kompetenca;
- Të punohet për hapjen e programeve të reja të studimit, me karakter ndërdisiplinor, në bashkëpunim me Universitete europiane, në kuadrin e projekteve të mbështetura nga BE;

**Spektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni  
Evis Kapurani**